

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-218/2014

**Prishtinë
6 Tetor 2016**

Në çështjen juridike të:

Z.S.

Fshati Koretishte
Gjilan

Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Sylejman Nuredini, kryetar i kolegjit, Anna Bednarek dhe Beshir Islami, gjyqtarë, duke vendosur me ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrat KPA90309 dhe KPA01140), pas shqyrtimit të mbajtur më 5 Tetor 2016 mori këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesat e paraqitura nga Z.S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013 të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-218/2014 dhe GSK-KPA-A-219/2014 bashkohen në një lëndë të vetme nën numrin GSK-KPA-A-218/2014.
2. Ankesat e paraqitura nga Z.S. ndërvendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013 sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA01140 dhe KPA90309 refuzohen si të pabazuara.

3. Vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/220/2013 i datës 27 nëntor 2013 vërtetohet sa i përket kërkesave të regjistruara në AKP me numrat KPA90309 dhe KPA01140.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 10 tetor 2007, Z.S. (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur dy kërkesa të ndara Agjencisë Kosovare të Pronës (tani e tutje: “AKP”) në cilësi të anëtarit të familjes së bartësit të së drejtës pronësore: tani nënës së tij të ndjerë S.S. . Kërkesat ishin regjistruar në AKP me numrat KPA90309 dhe KPA01140, dhe i referohen ngastrës përkatëse kadastrale nr. 27/2 në sipërfaqe të përgjithshme prej 00.53.05 ha dhe ngastrës kadastrale nr. 29 në sipërfaqe të përgjithshme prej 1.04.28 ha, të dyja me lokacion në vendin e quajtur “Sejtagin Zabel” në Gjilan (tani e tutje “pronat e kërkuara”).
2. Asnjëra kërkesë nuk përmban deklaratë sa i përket çështjes nëse humbja e posedimit të pronave të kërkuara lidhet me konfliktin e armatosur që ndodhi në Kosovë periudhën ndërmjet 1998 dhe 1999.
3. Në mbështetje të kërkesës së tij, pala ankuese ka dorëzuar në AKP, në mes tjerash, këto dokumente:
 - Procesverbalin up.nr.463-52/91, të përpiluar më 6 mars 1997 nga Komisioni i Ministrisë së Bujqësisë, Ujërave dhe Pylltarisë i Komunës së Gjilanit lidhur me procedurën administrative për rikthimin e tokës. Në procesverbal mund të lexohet se Komisioni njëzëri ka vërtetuar se kushtet e kthimit e tokës janë plotësuar dhe i kanë njoftuar palët (përfaqësuesin e S.S. -it dhe Ndërmarrjen Bujqësore Industriale NBI “Mladost”) se mund të bëjnë marrëveshje për kompensimin e S.S. -it me një tokë tjetër korresponduese, me kusht që toka e shpronësuar paraprakisht të jetë bartur në pronësi private. Gjatë seancës palët lidhën marrëveshje dhe S.S. mori kompensim për pronat e kërkuara;
 - Kopjen e certifikatës së lindjes së Z.S. nr. 77/1952 të lëshuar nga Komuna e Gjilanit më 13 qershor 2007 me numër 200-6832/2;
 - Kopjen e certifikatës së vdekjes së motrës së palës ankuese nr. 02/2005 të lëshuar nga Komuna e Gjilanit më 24 janar 2005 me numër 03-203-205/V-21;
 - Një kopje të kërkesës së paraqitur më 10 qershor 2007 në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për vërtetimin e të drejtës pronësore mbi pronën e paluajtshme për të njohur Z.S. -in si pronarin e pronave të kërkuara dhe të ngastrave të tjera;
 - Kopjen e vendimit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës të lëshuar në lëndën nr. SCC-05-0215 më 20 shkurt 2006 në bazë të së cilit lënda është referuar në Gjykatën Komunale të Gjilanit.
4. Të gjitha dokumentet e lartpërmendura janë verifikuar negativisht. Më 21 gusht 2008 Ekipi i AKP-së për Verifikim gjeti *ex-officio* Certifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme nr. P-

70403013-00027 dhe 00029-0 të lëshuar nga Zyra Komunale për Kadastër në Gjilan. Sipas certifikatave rrjedh se pronat e kërkuara janë të regjistruara në emra të pronarëve të ndryshëm, përkatësisht e tërë ngastra nr. 27 është e regjistruar në emër të Z.B. dhe ngastra nr. 29 në emër të I.H.. Përveç kësaj, më 1 gusht 2009 janë siguruar edhe certifikata të tjera. Duket se ngastra nr. 27 ishte e regjistruar në emra të katër personave të familjes S., gjersa ngastra nr. 29 ishte e regjistruar në emër të Kombinatit Bujqësor Industrial “Agrokultura”.

5. Identifikimi fillestar i kërkesës në lëndën AKP01140 ishte bërë më 11 dhjetor 2008, por më vonë ishte konsideruar si i pasaktë. Gjatë atij njoftimi tokë është gjetur se ishte livadh i pa uzurpuar. Ekipi i AKP-së për njoftim në raportin e njoftimit ka përmendur se: “Prona ishte gjetur me ndihmën e paditësit z. Z.S. i cili ishte i pranishëm gjete njoftimit. Ndërmarrja e paditur Mladost ishte shitur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit prandaj ndërmarrja siç tregohet nga pala e paditur nuk ekziston më”.
6. Identifikimi fillestar i kërkesës në lëndën AKP90309 ishte bërë më 15 dhjetor 2008, por më vonë ishte konsideruar si i pasaktë. Gjatë atij njoftimi tokë është gjetur se ishte livadh i pa uzurpuar. Ekipi i AKP-së për njoftim në raportin e njoftimit ka përmendur se: “Prona ishte gjetur me ndihmën e banorëve lokalë dhe në bazë të hartës”
7. Njoftimi i ri për dy kërkesat ishte bërë më 17 qershor 2010 përmes publikimit në Gazetën për Njoftime të AKP-së nr. 2 (të shpërndarë në Komunën e Gjilanit, Zyrën Komunale për Kadastër në Gjilan, Gjykatën Komunale në Gjilan, dhe Zyrën Rajonale të AKP-së në Gjilan. Përveç kësaj, Gazeta ishte shpërndarë edhe në Zyrën Rajonale të UNHCR-së dhe te Avokati i Popullit.
8. Lënda ishte konsideruar si e pa kontestuar nga AKP-ja për faktin se asnjë palë e interesuar nuk është paraqitur në Agjenci.
9. KKPK-ja me vendimin e vet të apeluar KPCC/D/A/220/2013 të datës 27 nëntor 2013 ka hedhur poshtë kërkesat me numër KPA01140 dhe KPA90309 me arsyetim se pala ankuese nuk ka arritur të tregojë se kërkesat përfshijnë rrethana që lidhen drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i viteve 1998-1999. Rrjedhimisht, sipas Komisionit, kërkesat janë jashtë mandatit të tij.
10. Vendimi i KKPK-së është dorëzuar palës ankuese më 9 qershor 2014.
11. Pala ankuese ka paraqitur ankesat më 24 qershor 2014.

Pretendimet e palës ankuese

12. Pala ankuese kundërshton vendimet e KKPK-së me pretendimin se bazohen në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe si të tilla vendime të privojnë atë nga “e drejta kushtetuese ligjore për shfrytëzim dhe regjistrim në të dhënat në kadastër në pajtim me

marrëveshjen nr. 463-52/91. Ai po ashtu deklaroi se prona ishte “në pronësi të tij deri në qershor 1999, duke u thirrur në marrëveshje të vlefshme”. Ai pohon se “kishte kultivuar sipërfaqen e punueshme më 1997, 1998 e deri më 1999”. Ai konteston të gjitha pretendimet se luftimet në atë zonë nuk kanë pasuar efekt në humbjen e pronës dhe regjistrimin e saj në të dhënat kadastrale. Më tutje pala ankuese ka kërkuar “pse ai vetë si qytetar i Kosovës nuk mund të fitojë të drejtën e tij administrative për regjistrimin e marrëveshjes së vlefshme “. Ai po ashtu ka qartësuar se “për shkak të situatës që mbretëronte në Kosovë marrëveshja mbeti e paregjistruar në të dhënat kadastrale në Gjilan. (...) Prona në marrëveshje, tani e të ndjerës S.S. tjetërsohet pasi i është nënshkruar Shqiptarëve nga Gjilani. Po të njëjtit tani po kërkojnë (nga pala ankuese) ta bart pronën në emër të tyre, janë duke i bërë shantazh dhe duke e kërcënuar (palën ankuese)”. Ai shton se dokumentet që mund t’i ndihmojnë për ta dëshmuar të drejtën pronësore janë shkatërruar gjatë luftës.

Arsyetimi ligjore

Bashkimi i ankesave

13. Në përputhje me paragrafin 13.4 të Ligjit nr. 03/L-079, Gjykata Supreme mund të vendosë mbi ankesat e bashkuara, kur ky bashkim i kërkesave është vendosur nga Komisioni në përputhje me nenin 11.3 (a) të Ligjit. Ky nen lejon Komisionin të marrë parasysh bashkimin apo shkrirjen e kërkesave me qëllim të marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.
14. Dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore zbatohen në procedurën para Kolegjit të Apelit të Gjykatës Supreme në përputhje me nenin 12.2 të Ligjit nr. 03/L-079, si dhe në bazë të nenit 408.1 në lidhje me nenin 193 Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata Supreme mund t’i bashkojë lëndët përmes një aktvendimi nëse kjo do të siguronte efikasitet të gjykatës të lëndës.
15. Në tekstin e ankesave të paraqitura nga pala ankuese, Gjykata Supreme vëren se përveç numrit të ndryshëm të lëndës për paraqitjen e ankesës përkatëse, faktet, bazat ligjore dhe çështjet e provave janë të njëjta në të dyja lëndët. Vetëm ngastrat kadastrale, subjekt i të drejtës pronësore të pretenduar në secilën kërkesë ndryshojnë. Ankesat janë të bazuara në deklaratë të njëjtë sqaruese dhe në dokumentacion të njëjtë. Përveç kësaj, arsyetimi ligjor i KKPK-së për këto kërkesa është i njëjti.
16. Prandaj ankesat e regjistruara me numrat GSK-KPA-A-218/14 dhe GSK-KPA-A-219/14 janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-218/14.

Meritat

17. Gjykata Supreme e Kosovës gjen se vendimi i apeluar i KKPK-së ishte lëshuar me vërtetim të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe mbi këtë bazë si ligji material ashtu edhe ai procedural janë zbatuar drejt. Prandaj, ankesa refuzohet si e pabazuar.

18. KKPK konstatoi e pala ankuese nuk arriti të tregojë se kërkesat përfshijnë rrethana që lidhen drejtpërdrejt ose që rezultojnë nga konflikti i armatosur i viteve 1998-1999. Pala ankuese kundërshtoi mendimin e KKPK-së. Megjithatë, është me rëndësi të theksohet se pala ankuese në kërkesat e tij vërtetë nuk ka treguar kur kishte ndodhur humbja e posedimit dhe se kishte të bëjë me konfliktin e armatosur. Në arsyetimin e kërkesave Z.S. ka treguar vetëm se prej se situata në Kosovë ishte zhvilluar ai kishte tentuar vazhdimisht të regjistronte pronat në emrin e tij, por pa sukses. Në vend të kësaj ankesa përmban deklaratën e palës ankuese se vendimi i KKPK-së ka shkelur të drejtën e tij kushtetuese për shfrytëzimin dhe regjistrimin e pronës në emrin e tij. Dokumentet e paraqitura bashkë me kërkesat e tij i referohen çështjes së regjistrimit të së drejtës pronësore në të dhënat kadastrale. Këto rrethana na qojnë deri të përfundimi se ne fakt kërkesa përmbante propozimin për t'i mundësuar palës ankuese regjistrimin e pronave të kërkuara në emrin e tij. Megjithatë, as KKPK-ja e as Kolegji i Ankesave i AKP-së nuk janë kompetentë ta ekzaminojnë çështjen e ekzekutimit të marrëveshjes së nënshkruar nga palët gjatë procedurës administrative shumë kohë para konfliktit të armatosur të vitit 1998/1999. Kërkesa e tillë bie jashtë juridiksionit të KKPK-së, edhe pse, siç ka treguar pala ankuese, konflikti ka mundur të ndikojë në vështirësimin e regjistrimit të së drejtës pronësore në të dhënat kadastrale.
19. Sipas mendimit të Gjykatës Supreme pala ankuese nuk ka dëshmuar se vërtetë kishte në posedim pronat e kërkuara para konfliktit dhe se humbja e posedimit të tyre kishte ndodhur mes viteve 1998 dhe 1999 për shkak të luftës ose se kishte të bëjë me konfliktin e armatosur. Dokumentet e paraqitura nuk e vërtetojnë fare këtë rrethanë. Nuk është e mjaftueshme, për pranimin e kërkesës, mohimi i përmbajtjes së vendimit të KKPK-së. Ato elemente duhet të provohen pa asnjë dyshim. Asnjë dokument nuk konfirmon se pala ankuese ose nëna e tij e ndjerë kishin në posedim pronat e kërkuara para konfliktit të armatosur.
20. Përveç kësaj, vetë pala ankuese në ankesë tregon se: “prona në marrëveshje, tani e të ndjerës S.S. tjetërsohet pasi i është nënshkruar Shqiptarëve nga Gjilani. Po të njëjtit tani po kërkojnë (nga pala ankuese) ta bart pronën në emër të tyre, janë duke i bërë shantazh dhe duke e kërcënuar (palën ankuese)”. Kjo deklaratë qartëson se pronat e kërkuara nuk ishin në posedim të as nënës së ndjerë të palës ankuese, e as në posedim të tij pas vitit 1991, shumë kohë para fillimit të konfliktit të armatosur.
21. Prandaj, vendimi i KKPK-së vërteton se humbja e posedimit për shkak të konfliktit të armatosur nuk është dëshmuar dhe se kërkesat hedhen poshtë.
22. Vlen të përmendet këtu se pala ankuese ka dorëzuar në shkresa të lëndës dokumente që konfirmojnë rrethanat në vitin 2005 ishte paraqitur kërkesa për konfirmimin e të drejtës pronësore dhe për regjistrimin e pronës në emër të nënës së palës ankuese pranë Gjykatës Komunale të Gjilanit. Neni 18 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i ndryshuar me Ligjin 03/L-079 përcakton si në vijim “*Dispozitat e kësaj Rregulloreje zbatohen për çdo kërkesë nga neni 3.1 i kësaj Rregulloreje që është parashtruar pranë gjykatës me kompetencë territoriale, me kusht që procedura gjyqësore*

lidhur me kërkesën e tillë të mos ketë filluar para datës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje". Fakti që kërkesa lidhur me pronën e kërkuar ishte paraqitur pranë Gjykatës Komunale para hyrjes në fuqi të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 përjashton juridiksionin e KKPK-së. Prandaj, kërkesat e palës ankuese duhet të hedhen poshtë edhe për shkak të këtij fakti.

23. Për shkak të gjitha arsyeve të lartpërmendura, në pajtim me nenin 13.3.(c) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 i ndryshuar me Ligjin 03/L-079 dhe me nenin 195, paragrafin 1(d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Këshillë juridike

24. Në pajtim me nenin 13.6 të Ligjit 03/L-079 ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Sylejman Nuredini, Kryetar i kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtare e EULEX-it

Beshir Islami, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte , Referente e EULEX-it